

NË EMËR TË POPULLIT

P.

nr.662/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit H.Xh. nga ..., për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.945/2017 të datës 27.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 16.01.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Slavica Mavric, të pandehurit dhe të dëmtuares, me datë 17.01.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.01.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H.Xh., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me dt. ... në ..., ku edhe jeton, Rr. "...i" nr.3/5, i vetëpunësuar, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

Me datë 12.07.2014, rreth orës 21:40, në shtëpinë e përbashkët familjare e cila gjendet në ..., Rr. "...", i ka shkaktuar lëndime trupore personit tjetër dhe atë bashkëshortes së tij – të dëmtuarës V. T. Xh., ashtuqë pas një mosmarrëveshje të vazhdueshme e në gjendje të dehur dhe atë 1.27 promila, të njëjtën fillimisht e ka ofenduar me fjalë banale e pastaj ka filluar ta demolojë shtëpinë duke thyer enët në kuzhinë, pastaj e ka sulmuar duke e goditur të dëmtuarën me grushta në kokë dhe në fytyrë si dhe duke e konosur se "kam me të vra", me ç`rast të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë, kontuzion në regjionin muroro-tëmbllorë majtas të kokës, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Me këtë ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj Gjykatat në baze të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 49, 50, 51, 52, 73 të KPRK-se, dhe nenit 450, 460 të KPP-së, i:

S H Q I P T O N

- I.DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve nga plotëfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. OBLIGOHET** i pandehuri H. Xh., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë, në emër të ekspertizës mjekoligjore shumë prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.945/2017 të datës 27.11.2017, ndaj të pandehurit H. Xh. nga ..., për shkak te veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri: e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor, se e kuptoj natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, shprehi keqardhje për krejt këtë që ka ndodhur, e po ashtu kam shprehur keqardhje në polici ditën kritike, raportet bashkeshortore tani janë shumë të mira e po ashtu i premtoj gjykatës që nuk do të ndodhin gjëra të tilla në të ardhmen sepse nuk jam njeri i tillë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se propozoj që te pranimi i fajësisë e cila është dhënë vullnetarisht, i pandehuri nuk mohon kryerjen e veprës dhe ky pranim është në përputhje edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, duke i propozuar gjykatës që të marr vendim sipas ligjit si dhe të marr parasysh këtë pranim të fajësisë si rrethane lehtësuese, faktin se i pandehuri dhe e demtuara jetojnë bashkerisht, janë të shtyre në moshe dhe se fakti se i pandehuri pendohet për kryerjen e veprës dhe mënyrës si ka ardhur te ky rast.

E dëmtuara V. T. lidhur me pranimin e fajësisë deklaron se tani raportet në mes nesh janë të mira, nuk kemi probleme, dhe e luti gjykatën që të përfundojë këtë lëndë në mënyrën më të lehtë të mundshme.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri H. Xh., e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti mjekësor në emër të dëmtuarës V.T – Xh. nr. 9147, i datës 14.05.2014; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjekoligjor Dr. Naim Haliti për të dëmtuarën, i datës 07.11.2017; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici, e datës 16.07.2014; Deklarata e të dëmtuarës V. T. e dhënë në polici, e datës 14.07.2014; Deklarata e të demtuarës V.T. e dhënë në Prokurori, e datës 01.11.2017; Ekstraktin nga dosja penale për të pandehurin; Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri H. Xh. ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri H. Xh.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit H. Xh. dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë vepër e kishte kryer me dashje, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qellim të mbrojë jetën dhe trupin e individit, rrethanat më të cilat është kryer vepra po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese.

Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprat penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, në raport me gjykatë dhe palët, dhe se nga deklarimi i palëve në seancë, raportet mes tyre janë përmirësuar, jetojnë bashkë si bashkëshortë pas ndodhjes së kësaj veprë. Këto tregojnë se raportet mes tyre janë përmirësuar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e ekspertizës dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.662/2017 dt.25.01.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.